



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT KORÇË

VENDIM

Nr. 11 datë 15/03/2024

PËR

MIRATIMIN E PËRBËRJES SË KOMISIONIT TË MBROJTJES TË TOKËS NË QARK

Bazuar në ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, në nenin 8 të Ligjit 9244 Dt. 17.06.2004 “Për Mbrojtjen e Tokës Bujqësore”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.80, datë 28.01.2005 “Për përbërjen, mënyrat e funksionimit, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave shtetërore të mbrojtjes së tokës bujqësore”, Kreu III, bazuar edhe në ndryshimet e emërtimeve të institucioneve përgjegjëse të përcaktuar në dispozitata ligjore të sipërcituara, me propozim të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Korçë.

VENDOSI

- I. Të miratojë Komisionin e Mbrojtjes së Tokës në qark sipas përbërjes më poshtë:
- | | |
|----------------------------------------------------------------------------------------|----------|
| • Kryetari i Këshillit të Qarkut Korçë | Kryetar |
| • Drejtor i DAMT Qarku Korçë | Sekretar |
| • Kryetar i Bashkisë Korçë | Anëtar |
| • Kryetar i Bashkisë Maliq | Anëtar |
| • Kryetar i Bashkisë Pogradec | Anëtar |
| • Kryetar i Bashkisë Devoll | Anëtar |
| • Kryetar i Bashkisë Kolonjë | Anëtar |
| • Kryetar i Bashkisë Pustec | Anëtar |
| • Drejtori i Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujësor Korçë | Anëtar |
| • Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Inspektoriatit Kombëtar të mbrojtjes së Territorit | Anëtar |
| • Drejtori i Qendrës të Transformimit të Teknologjive Bujqësore | Anëtar |
| • Dekani i Fakultetit të Bujqësisë në Universitetin F.S.Noli Korçë | Anëtar |
| • Drejtori i Drejtorisë të Ujitjes dhe Kullimit | Anëtar |
| • Drejtori i Njësisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Korçë | Anëtar |
| • Drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë | Anëtar |
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI I KËSHILLIT TË QARKUT

Konceptoi: A.Lisi/M.Jano
Juristi: Gj.Kristo
Sek.Kësh.Qarkut: B.Muço

ERJON NEXHIPI



RELACION
PËR
MIRATIMIN E PËRBËRJES SË KOMISIONIT TË MBROJTJES TË
TOKËS NË QARK

Bazuar në Ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendcre” dhe në nenin 8 të Ligjit 9244 datë 17.06.2004 “Për mbrojtjen e Tokës Bujqësore” Këshilli i Qarkut ka për detyrë miratimin e përbërjes së Komisionit të Mbrojtjes së Tokës në Qark. Duke marrë shkas nga ndryshimet e emërtimeve të institucioneve përgjegjëse në dispozitat ligjore të sipërcituara, ku anëtarët janë nominalë (me emra të përvetshëm) dhe jo në bazë të funksionit, i relatojmë Këshillit të Qarkut Korçë për marrjen e vendimit për përcitësimin e përbërjes së anëtarëve të Komisionit të Mbrojtjes së Tokës në Qark.

Sipas nenit 8 të Ligjit 9244 Dt.17.06.2004 “Për Mbrojtjen e Tokës Bujqësore” në përbërje të këtij komisioni marrin pjesë:

pika 2: kryetarët e bashkive, drejtori i policisë në prefekturën e qarkut, përgjegjësi i agjencisë rajonale të mjedisit, drejtuesi i policisë ndërtimore, drejtori i drejtorisë rajonale të bujqësisë dhe ushqimit, drejtori i drejtorisë rajonale të ujerave, drejtori i drejtorisë së shërbimit pyjor, si dhe drejtues të institucioneve, veprimtaria e të cilave ndikojnë mbi token bujqësore. Këta të fundit miratohen nga këshilli i qarkut.

pika 3: Komisioni i Mbrojtjes së Tokës organizon grupe të veçanta me specialistë të institucioneve të ndryshme në territorin e qarkut për të verifikuar, kontrolluar ose studiuar çështje të veçanta për masat mbrojtëse për token bujqësore.

pika 4: Kryetari i këshillit të qarkut është njëkohësisht edhe kryetari i KMT -se.

Bazuar në emërtimet aktuale të institucioneve përgjegjëse sipas dispozitave ligjore aktuale, Kryetari i këshillit të qarkut propozon përbërjen e Komisionit të Mbrojtjes së Tokës në Qark si më poshtë:

- | | |
|----------------------------------------------------------------------------------------|----------|
| • Kryetari i Këshillit të Qarkut Korçë | Kryetar |
| • Drejtor i DAMT Qarku Korçë | Sekretar |
| • Kryetar i Bashkisë Korçë | Anëtar |
| • Kryetar i Bashkisë Maliq | Anëtar |
| • Kryetar i Bashkisë Pogradec | Anëtar |
| • Kryetar i Bashkisë Devoll | Anëtar |
| • Kryetar i Bashkisë Kolonjë | Anëtar |
| • Kryetar i Bashkisë Pustec | Anëtar |
| • Drejtori i Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Korçë | Anëtar |
| • Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Inspektoriatit Kombëtar të mbrojtjes së Territorit | Anëtar |

- Drejtori i Qendrës të Transformimit të Teknologjive Bujqësore
- Dekani i Fakultetit të Bujqësisë në Universitetin F.S.Noli Korçë
- Drejtori i Drejtorisë të Ujitjes dhe Kullimit
- Drejtori i Njësive Vendore të Kujdesit Shëndetësor Korçë
- Drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë

Anëtar

Anëtar


Anëtar

Anëtar

Anëtar

Referuar:

A. Lisi



M. Jano

